



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 232 prot.

Tiranë, më 08.02.2023

V E N D I M

Nr. 27, datë 08.02. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² shqyrtoi ankesën nr. 177, datë 18.11.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku”³, përfaqësuar nga znj. Suela Lala, Drejtore Ekzekutive, kundër Universitetit Politeknik të Tiranës, me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuara, në godinën e Korpusit në Sheshin “Nënë Tereza” dhe veçanërisht në godinat e Universitetit në anën e pasme që janë rikonstruktuar së fundmi, për mosgarantimin e aksesueshmërisë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, në kuadër të aktivitetit të saj është duke zhvilluar leksione të hapura në pesë universitete në vend. Në 15 nëntor 2022, znj. Suela Lala, Drejtore Ekzekutive e Fondacionit “Së bashku”, nuk mundi të merrte pjesë në një aktivitet për shkak se godina nuk ishte e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse godina e rikonstruktuar ka ashensorë për katet e sipërme, nuk mund të hysh në ndërtesë dhe të marrësh ashensorë për shkak të barrierave në hyrje të ndërtesës. Nuk ka vende parkimi për personat me aftësi të kufizuara dhe elemente për personat me aftësi të kufizuara në shikim.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, nga Universiteti Politeknik i Tiranës në godinën e Korpusit në Sheshin “Nënë Tereza” dhe veçanërisht në godinat e Universitetit në anën e pasme që janë rikonstruktuar së fundmi, për mosgarantimin e aksesueshmërisë.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Në vijim do t’i referohemi me “Pala ankuese”

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’ a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik me vendimi nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Fondacioni “Së bashku” nuk pretendon se është cënuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuar për mosgarantimin e aksesueshmërisë në godinën e Korpusit në Sheshin “Nënë Tereza”.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore*

ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri shqyrtoi çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1505/1 prot., datë 30.11.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Universiteti i Tiranës, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Komisioneri sqaron se, fillimisht ankesa objekt shqyrtimi është drejtuar kundër Universitetit të Tiranës.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Universiteti i Tiranës me shkresën nr. 3310/1 prot., datë 07.12.2022⁴ ka informuar Komisionerin se e ka përcjellë shkresën nr. 1505/1 prot., datë 30.11.2022, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës.

2. Me anë të kërkesës së datës 10.01.2023, të dërguar me anë të *e-mailit*, pala ankuese ka saktësuar se subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa është Universiteti Politeknik i Tiranës. Në këto kushte, me shkresën nr. 96 prot., datë 17.01.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) me shkresën nr. 128/1 prot., datë 31.01.2023⁵ ka kthyer përgjigje, duke parashtruar si vijon:

Së pari, UPT, thekson se nuk ka patur informacion lidhur me problematikën e hasur nga znj. Suela Lala, e cila sipas tyre nuk ka informuar apo kërkuar asistencë nga strukturat përkatëse pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit apo Rektoratit të UPT. Pretendimi se nuk ka mundur të marrë pjesë në aktivitetet për shkak se godina nuk ishte e aksesueshme nga personat me

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1505/2 prot., datë 09.12.2022.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 96/1 prot., datë 03.02.2023.

aftësi të kufizuar, nuk përputhet me përmbajtjen e dokumentacionit provues të paraqitur dhe konkretisht foto të katit përdhes të ndërtesës, ku rezulton se ka mundur të hyjë dhe të marrë pamje të pjesës së brendshme të godinës. Gjithashtu, UPT sqaron se, nga dita kur ndërtesa është vënë në përdorim, nuk është hasur asnjë problematikë nga vizitorë të mundshëm, që lidhet me pamundësinë e hyrjes në godinën e Shtesës së Korpusit Qëndror.

Së dyti, UPT sqaron se, projekti i godinës së Fakultetit të teknologjisë së Informacionit (Shtesa e Korpusit Qendror të UPT), është miratuar me vendimin e KKT Nr. 8, datë 10.05.2013, ka nisur ndërtimin në vitin 2013 dhe ka përfunduar në vitin 2015. Ndërtesa, duke mbajtur në konsideratë kriteret dhe elementët teknikë të parashikuara në VKM-në nr. 1503, datë 19.11.2008 “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*”, për përdorimin e saj nga personeli dhe studentët me aftësi të kufizuara lëvizëse, është e përshtatur për aksesueshmërinë e kësaj kategori individësh. Përshtatja e ambienteve për personat me aftësi të kufizuar përfshin kriteret ndërtimore, si dhe kriteret e mobilimit, duke mbajtur në konsideratë që për studentët me aftësi të kufizuar të përshtaten ambientet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Kriteret ndërtimore të ndërtesës dhe hapësirave të jashtme të saj sigurojnë gjerësi dyersh për kalimin e karriges me rrota. Të gjitha klasat, sallat e leksioneve dhe laboratorët kanë hapësira të mjaftueshme për përshtatjen e mobilimit për kalimin e pandërprerë të personave me karrige me rrota. Të gjitha ambientet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor janë të aksesueshme me ashensor me përmasa të përshtatshme dhe korridoret plotësojnë kushtet e parashikuara nga legjislacioni. Godina disponon tualete të përshtatur dhe shkallë evakuimi me gjerësi rampash dhe pjerrësi standarde, ndërsa parkimi nëntokësor përmban vendparkime me përmasa të përshtatshme.

UPT, thekson se, misioni bazë i këtij institucioni është zhvillimi i aktivitetit akademik dhe kërkimor shkencor dhe mbështetur në nenin 25 të VKM-së nr. 1503, datë 19.11.2008, përshtatja e ndërtesave të institucioneve të arsimit të lartë, duhet të sigurojnë përdorimin e tyre për nxënës (në këtë rast student) me aftësi të kufizuar lëvizëse. Për këtë qëllim, institucioni kryen çdo vit analiza për numrin e studentëve me aftësi të kufizuar, nga ku rezulton se në 10 (dhjetë) vitet e fundit, në fakultetet që zhvillojnë veprimtarinë në kompleksin e Korpusit Qendror (përfshirë godinën e Shtesës së Korpusit Qendror), nuk ka patur studentë me aftësi të kufizuar lëvizëse. Megjithatë, pavarësisht se pranë këtyre fakulteteve nuk ndjekin studimet studentë me aftësi të kufizuar lëvizëse, përsëri institucioni ka përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi për aksesin në godinën të personave me aftësi të kufizuar.

Aktualisht hyrja në ndërtesë realizohet në pjesën ballore ku trotuari është përshtatur për të garantuar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara dhe në pjesën anësore nëpërmjet rampës, sipas fotografive bashkëlidhur.

3. Me anë të *e-mailit* datë 03.02.2023 dhe *e-mailit* datë 06.02.2023, pala ankuese ka informuar Komisionerin se, pasi u njohën me shkresën nr.128/1 prot., datë 31.01.2023, të dërguar nga UPT, vlerësojnë masat e marra nga ana e subjektit, konsiderojnë se, me marrjen e këtyre masave është arritur qëllimi i ankesës së paraqitur pranë Komisionerit dhe tërhiqen nga ankesa.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ka filluar procedura administrative është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, përcaktohet: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 177 regjistri, datë 18.11.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së bashku” kundër Universitetit Politeknik të Tiranës, duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 177, datë 18.11.2022, të paraqitur nga Fondacioni “Së Bashku” kundër Universitetit Politeknik të

Tiranës, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura administrative.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e Kufizuar
Fusha: Shërbime/Aksesueshmëri/Institucion i arsimit të lartë
Lloji i vendimit: Ndërprerje e procedurës pa vendim përfundimtar/Arritje efektiviteti